



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.02.2023)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:27.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>3. Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>5. Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Marçela Shehu</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>9. Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Klodian Kurushi.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njesisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.*

*3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

*4. Staf administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>1</sup>

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë, në rendin e ditës datë 23.02.2023, ora 14:00, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Toro për të vijuar me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat e rrethit gjyqësor Krujë, Dibër, Pogradec, Lezhë, Pukë, Gjirokastrë dhe nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksioni penal.

---

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Ardiana Bera.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë penale, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë penale të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë, nuk përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, konkretisht: z. Artan Çupi.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Suela Lika.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: z. Besnik Shehu.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2 penale, Luljeta Kole.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: z. Aurel Arapi.

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet z. Ded Miri, për të cilin është përcjellë shkresa nga gjykata Kurbin se përjashtohet nga shorti për shkak të përfundimit të statusit për shkak të moshës së pensionit, si edhe znj. Alda Sadiku, e cila ka shkaqe ligjore për t'u përjashtuar në çështjen me numër rendor 1 në tabelë.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Olti Skrame dhe Aurel Arapi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Olti Skrame.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhen të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër: z. Sokol Shehu.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Arbër Çela.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Tonin Sterkaj dhe Arbër Çela.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, konkretisht: z. Enkel Peza, si dhe znj. Vjola Canaj për shkak të ngarkesës së saj në çështjet gjyqësore.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Herila Çela.

Vijohet me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, e cila ka paraqitur nevojë në 2 çështje, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. (Në relacion gjenden bashkëlidhur lista e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet.)

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit. Në relacion përmenden emrat e gjyqtarëve.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Aurel Arapi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Edvan Veçani.

Mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**